



PËRISË  
SHOQERIA RAJONALE UJESJELLES KANALIZIME SHKODER

DATE 14.11.2024

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: Supervizion punimesh per objektin ” Ndertim i Ujesjellesit te Bajzes dhe fshatrat perreth, Loti i II Bashkia Malesia e Madhe”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):  
71247000-1 “Mbikëqyrja e punës së ndërtimit”**

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 2.021.470 (Dy milion e njezet e nje mije e katerqind e shtatedhete) leke pa TVSH, vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit.

Në bazë të Nenit 21, pika 2 të Ligjit Nr. 16/2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar me VKM Nr.498, datë 1.8.2024, autoriteti/enti kontraktor **Shoqeria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Shkoder** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenet 76, 82 dhe 83 të LPP te ndryshuar me Ligjin Nr.16/2024 dhe Nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. te ndryshuar me VKM Nr. Nr. 498, datë 1.8.2024

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

## 2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

- Sipas kritereve të përgjithshme

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP te ndryshuar me Ligjin Nr.16/2024, nenit 41, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" te ndryshuar me VKM Nr. 498, datë 1.8.2024.

## 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare.2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së parashikuar të kontratës (vlera e fondit limit).

*Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP te ndryshuar me Ligjin Nr.16/2024, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". te ndryshuar me VKM Nr. 498, datë 1.8.2024

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedure është "E Hapur e Thjeshtuar Shërbime", përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet se: 40% të vlerës së parashikuar të kontratës në procedurat e prokurimit dhe në procedurat e prokurimit E Hapur e Thjeshtuar Shërbime si dhe në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar,*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar është bërë në mbështetje VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" te ndryshuar me VKM Nr. 498, datë 1.8.2024 ku përcaktohet se: " Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare".*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të konfirmuara nga administrata tatimore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

*Shenim: Kjo kërkesë per kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar me VKM Nr. 498, datë 1.8.2024. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në Nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

---

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, si dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar me Ligjin Nr.16/2024 dhe nenin 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar me VKM Nr. 498, datë 1.8.2024. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme **për mbikqyrje** të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas përcaktimit në vendimin Nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e

---

koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në Nr.943 datë 28.12.2016”, me kategoritë si më poshtë:

**NP- 1** Punime gjurmimi në tokë

**NP- 7** Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje

**NS-18** Punime topogjeodezike

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar me Ligjin Nr.16/2024, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM Nr.285, datë 19.05.2021,“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar me VKM Nr. 498, datë 1.8.2024, si dhe *vendimin Nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në Nr.943 datë 28.12.2016” (shënim-përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente

Meqenese kemi të bëjmë me Mbikqyrjen e punimeve në zbatim argumentojmë se Kategorite e mesiperme janë përcaktuar në përputhje me zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventivin e punimeve të zbatimit për Objektin: **Ndërtim i Ujesjellesit të Bajzes dhe fshatrat perreth, Loti i II Bashkia Malesia e Madhe”, me nr. REF- 26571-10-28-2024.** Gjithashtu keto kategori license bazohen edhe në projektin/ Specifikimet teknike të punimeve të zbatimit për këte objekt.

**2.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:**

2.4.1 Drejtuesin e punimeve dhe Mbikëqyrësin e materialeve dhe cilësisë që duhet të jetë inxhinier Hidroteknik ose Ndërtimi me liçencë profesionale përkatëse, me eksperiencë pune në mbikëqyrje, i cili mban përgjegjësi për zbatimin e projektit sipas kushteve teknike të zbatimit, miratimin e volumeve të punimeve, çertifikaten e pagesës, mbajtjen, kontrollin dhe miratimin e gjithë dokumentacionit, miratimin e ndryshimeve të volumeve, ndjek dhe miraton cilësinë e produkteve, korrespondencën me SHRUKSH, miraton materialet dhe cilësinë e tyre, ndjek e miraton vendosjen e tyre në objekt dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit.

2.4.2 Inxhinieri për punimet ndërtimore që duhet të jetë inxhinier ndërtimi me liçencë profesionale përkatëse, me eksperiencë pune, i cili kontrollon dhe miraton ecurinë dhe cilësinë e punimeve dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit.

2.4.3 Inxhinieri për punimet hidroteknike që duhet të jetë inxhinier hidroteknik me liçencë profesionale përkatëse, me eksperiencë pune, i cili kontrollon dhe miraton ecurinë dhe cilësinë e punimeve dhe nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit.

**Shënim:** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Operatori ekonomik fitues, para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

Për secilin pjesëtar të stafit kryesor të mesiperme duhet të paraqesë:

Kontrate pune e vlefshme

Diplome

Libreze pune

---

CV

Licencat profesionale per mbikqyrje.

**\*\*\* Në këtë rasti stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” te ndryshuar me Ligjin Nr.16/2024 dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar me VKM Nr.498, datë 1.8.2024, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Njesia e prokurimit per vendosjen e stafit i eshte referuar Termave te references, gjithashtu argumentojme se zgjedhja e stafit të mbikqyrjes është bazuar në punimet respektive të përfshira në projekt preventivin e objektit **“Ndertim i Ujesjellesit te Bajzes dhe fshatrat perreth, Loti i II Bashkia Malesia e Madhe”**

**2.5** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtoare minimalisht **5 persona** për për periudhen 3 muajt e fundit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. **operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:**

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhen e 3 (tre) muajve te fundit duke marre si reference datën e hapjes se procedures.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhen e 3 (tre) muajve te fundit duke marre si reference daten e hapjes se procedures.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” te ndryshuar me Ligjin Nr.16/2024 dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar me VKM Nr. 498, datë 1.8.2024 , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtoare të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë: **per percaktimin e fuqise punetore minimale te kerkuar argumentojme se jemi bazuar ne sherbimet e kerkuara sipas Termave te references, ne preventivin: :“ Ndertim i Ujesjellesit te Bajzes dhe fshatrat perreth, Loti i II Bashkia Malesia e Madhe”**

*Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje 3 muajt e fundit, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikën sociale dhe*

---

*shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.*

**2.6 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë**

**ISO 9001:2015**                      **Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë**

**ISO 45001: 2018**                **Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë**

**Shenim:** Për çertifikatat e mesipërme operatorët ekonomik ofertues mund të paraqesin dokument ekuivalent që standartizon keto çertifikata sipas standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur keto çertifikata janë unifikuar nga kjo Drejtori.

*Të gjitha çertifikatat e mesipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatën e mesipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mesipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **aftësinë teknike dhe profesionale**;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë **se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”.

Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 përcaktohet: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin **çertifikata** të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë, standartet për shëndetin dhe sigurinë në punë si dhe standartet e menaxhimit të mjedisit.

Në bazë të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të mesipërme, autoriteti kontraktor vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme. Referuar natyrës së

punimeve që kërkohen të kryhen njësia e prokurimit ka kërkuar certifikatat e mësipërme për te vërtetuar se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime. Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret si më lart duke qenë në përpjesëtim dhe të lidhura me objektin e kontratës, por edhe sepse ato i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin e besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

- **Certifikatë ISO 9001 - 2015** “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi si dhe mundëson implikimin në menaxhim, identifikimin e riskut dhe mundësive, sigurimin e konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, etj. Kjo kërkesë shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, për të verifikuar dhe garantuar që operatori ekonomik ofertues është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë.
- **Certifikatë ISO 45001-2018** “Për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë”, ose **Certifikatë ISO 45001-2023**, mundëson që çdo shoqëri të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, dhe përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve, hetimin e incidenteve etj.
- Kjo kërkesë është vendosur duke iu referuar natyrës dhe specifikës që mbart objekti i prokurimit që lidhet me procese pune ndërtimi. Rreziqet që lidhen me punën në kantier janë të shumta e për këtë arsye, Autoriteti kontraktor duhet të sigurohet se Operoret ofertues zotërojnë kapacitetet për menaxhimin, kontrollin dhe parandalimin e risqeve për sigurinë e jetës dhe shëndetit gjatë procesit të punës. Pajisja me këtë lloj certifikate dëshmon se subjekti plotëson kërkesat e paraqitura nga ky standard për identifikimin, kontrollin dhe zvogëlimin e risqeve, të lidhura me shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës.

**SHENIM:** Oferta ekonomike e paraqitur nga Operatori Ekonomik duhet të jetë domosdoshmerisht në perputhje me VKM Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” si dhe duhet të jetë brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të kesaj VKM. Kjo kërkesë bazohet dhe në Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.5585 Prot datë 25.07.2017 “Mbi mënyren e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara ne Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016.

- Të gjitha ofertat që do të jene me vlere me të ulët se vlera minimale ose më të lartë se vlera maksimale e përcaktuar në VKM Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të

tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”, **do të refuzohen.**

---

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar me VKM Nr.498 date 1.8.2024,, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

---